

P Z A P  
I P Ž P



**Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalhe i Predstavke**

**A nr. 683/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendlodur përkthitazi me ankesën e Fadil Mjekiqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Obiliq paraqitur kundër anëtarëve të komisionit të vendvotimit (KVV), për shkak te mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Fadil Mjekiqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Obiliq.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Fadil Mjekiqi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Obiliq ne të cilën pretendohet se në vendvotimin 1503/01R dhe 1503/02D, në fshatin Breznicë komuna e Obiliqit dyshoj se më është manipuluar votat, andaj kërkoi nga ju që të behet hapja e kutive dhe të rinumërohen votat, sepse anëtarët e KVV-ve pikërisht ata të PDK-së ma kanë pavleftësuar votën, thuhet në pretendimet e ankimore.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminare i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtronet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parashev se “*Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një*

*vendvotim mund tē regjistroj mospajtimin tij nē librin e votimeve te vendvotimit dhe mund tē dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor pér Ankesa dhe Parashtresa nē pérputhje me këtë ligj*“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati pér anëtarë tē kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit tē parashroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar nē arsyet e sipershënuar dhe nē kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara nē fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i pérmbushin standarde*” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne tē cilin përcaktohet se: “*PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, tē parregullta apo te pa afatshme) ankesat, tē cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara nē nenin 3 tē këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë tē pabazuara, apo tē cilat janë nē pérputhje me dispozitat e duhura ligjore*”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor pér Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 683/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat pér ri-apelim, sepse vendimet e tij do tē konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet nē Nenin 118.4 tē LZP-së, ankesa nē Gjykatën Supreme tē Kosovës mund tē paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*